

## LIGJI PËR NDARJET BUXHETORE TË BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2023 NGA PIKËPAMJA GJINORE

### HYRJE

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) siguron që fondet publike buxhetohen dhe shpenzohen drejt adresimit të nevojave potencialisht të ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave, të identifikuar më parë përmes analizës gjinore. Sipas [Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore \(LBGj\)](#), BPGj është një detyrim për të gjitha institucionet publike, duke përfshirë komunat, ministritë dhe organizatat tjera buxhetore. Qeveria ka interes të zbatojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në kuadër të angazhimeve të saj për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, saktësisht [treguesi 5.c.1](#); Plani i Veprimit Gjinor i BE-së (GAP) III; Kornizën Plotësuese të Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësi Financiare (PEFA) për vlerësimin e menaxhimit të financave publike të përgjegjshme gjinore (GRPFM) në kontekstin e reformave të vazhdueshme të financave publike; dhe, më e rëndësishmja, si një praktikë më e mirë në menaxhimin financiar, drejt shpenzimeve publike më gjithëpërfshirëse. Kosova funksionon me fonde të pamjaftueshme, gjë që e bën të nevojshme që çdo euro e të hyrave publike të grumbulluara të ndahet në mënyrë strategjike për aktivitete që synojnë nevojat më urgjente për mirëqenien e individëve. Zbatimi i BPGj-së mund të kontribuojë në shpenzime më efektive, efikase, të përgjegjshme dhe transparente të burimeve qeveritare, duke përfshirë edhe arritjen e barazisë gjinore. Prandaj, kjo analizë diskuton Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2023 nga një pikëpamje gjinore, duke analizuar shkallën në të cilën merr parasysh nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave, djemve, si dhe avancimin e barazisë gjinore. Analiza gjithashtu evidenton se si qeveria ka përdorur mjetet e BPGJ-së në përgatitjen e buxhetit.

### TRENDET E BUXHETIT DHE PËRFSHIRJA GJINORE NË LIGJ

#### Transparenca dhe Llogaridhënia

Pasi Qeveria miratoi projektbuxhetin për vitin 2023 në tetor, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi atë në lexim të dytë në dhjetor. Edhe pse konsultimet publike janë të detyrueshme për të gjithë aktet ligjore[1] dhe disa prej akteve nënligjore, projektligji për Buxhetin asnjëherë nuk është vënë në dispozicion për konsultim publik. RrGK ka dërguar një kërkesë zyrtare për të shqyrtuar dhe komentuar projektligjin, por nuk ka marrë përgjigje nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe as nga Zyra e Kryeministrit.

#### Pasqyrë e trendeve të buxhetit dhe ndarjes së fondeve

Në përgjithësi, shpenzimet buxhetore në vitin 2023 pritet të jenë rreth 3.2 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 17%, ose rreth 464 milionë euro më shumë krahasuar me vitin 2022. Këtë vit ka pasur një rritje të konsiderueshme të subvencioneve dhe transfereve dhe mallrave dhe shërbimeve. Në kategoritë kryesore të shpenzimeve, rritja më e madhe buxhetore është reflektuar në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve me rreth 205 milionë euro, një rritje kjo prej 23%. Sa i përket mirëqenies sociale, llogaritjet sugjerojnë se buxheti për shëndetësinë rritur me 38

milionë euro, kurse pensionet dhe politikat sociale janë rritur me 39 milionë euro. Është e vështirë të përcaktohet sasia e përqindjes së buxhetit të Kosovës që ndahet për barazinë gjinore, kjo ngase që Kosova përdor buxhetimin e linjës dhe jo buxhetimin programor, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e fondeve për programe të veçanta, duke përfshirë programet drejt barazisë gjinore. Gjithashtu nuk ekzistojnë procedura të përcaktuara për matjen e fondeve të alokuara në mënyrë të qartë dhe të thukët për avancimin e barazisë gjinore.



[1] Ligji Nr. 04/L-025 për Iniciativat Legjislativë dhe Rregullorja (Grk) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimeve Publike, pikëpamjet e ADA ose Sida.

## Përfshirja gjinore

Sipas Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore, integrimi gjinor është “përfshirja e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit, planifikimit, miratimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave apo programeve dhe buxheteve, në të gjitha çështjet politike, ekonomike dhe fusha sociale, duke pasur parasysh promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta ndërmjet burrave dhe grave”.<sup>[2]</sup> Integrimi i duhur gjinor mund të bëhet me ndihmën e një analize gjinore dhe Vlerësimeve të Ndikimit Gjinor (VNGj) të cilat janë një kërkesë si pjesë e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ të kërkuar në Strategjinë e Rregullimit më të Mirë 2.0 dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024. Megjithatë, nuk është e qartë se ndonjë VNGj është kryer për të informuar Buxhetin. Lidhur me ndërthurjen, buxheti nuk përfshin ndonjë analizë të nevojave potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave të ndryshëm, duke përfshirë burra dhe gra të moshave, etnive, aftësive dhe vendndodhjeve të ndryshme gjeografike. Asnjë linjë apo nën-linjë specifike buxhetore nuk duket se adreson nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Një rishikim i ligjit të buxhetit sugjeron disa përpjekje për ta integruar perspektiven gjinore, ndonëse e pamjaftueshme. Termat gra/burra, femra/mashkull, as djem/vajza nuk përmend askund përgjatë dokumentit. Barazia Gjinore përmendet vetëm si një nga objektivat për sektorin e qeverisjes së përgjithshme publike<sup>[3]</sup>, si një nga objektivat të sektorit të rendit, ligjit dhe sigurisë publike <sup>[4]</sup>dhe si objektivi të sektorit të mbrojtjes sociale<sup>[5]</sup>. Asnjë linjë buxhetore nuk është përcaktuar qartë për të kontribuar në arritjen e këtyre objektiveve. Është e rëndësishme të theksohet se për herë të dytë<sup>[6]</sup>, buxheti përfshinte tregues të performancës për të gjithë sektorët. Treguesit e performancës janë të rëndësishëm për të matur suksesin e objektiveve të caktuara të vendosura nga qeveria dhe buxhetin e alokuar për to, si dhe për të zhvilluar llogaridhënien. Edhe pse një kërkesë e legjislacionit kombëtar duke përfshirë LBGJ, kornizat ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të BPGJ-së si PEFA, PEFA GRPFM dhe OKB SDG 5.c.1, asnjë tregues i performancës nuk lidhet në mënyrë eksplicite me barazinë gjinore.

Megjithatë, ka disa linja buxhetore që janë pozitive gjinore pa përmendur në mënyrë të qartë barazinë gjinore apo gratë në veçanti. Një shembull është vija buxhetore “Çështjet gjinore” në buxhetin e disa komunave. Megjithatë, vetëm 44% e komunave e kanë këtë linjë buxhetore. Në mesin e këtyre komunave, shuma totale e ndarë për këto linja buxhetore është 275,893€ në vitin 2023 krahasuar me 207,234€ në vitin 2022, me një shumë mesatare prej 16,229€ për komunë në vitin 2023 krahasuar me 13,816€ në vitin 2022. Kjo është buxhetuar kryesisht në kategorinë e pagat dhe mëditjet dhe mallrat dhe shërbimet, kryesisht duke mbuluar pozitat e zyrtarëve për barazi gjinore. Ndërkohë, zyrtarët për barazi gjinore kanë vërejtur se atyre u mungojnë burimet për zbatimin e përgjegjësive të tyre drejt avancimit të barazisë gjinore në komunat e tyre përkatëse. Asnjë nga komunat nuk ka linja të qarta buxhetore të përcaktuara në mënyrë eksplicite për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, as aktivitete me qëllim të avancimit të barazisë gjinore. Një linjë tjetër e rëndësishme buxhetore që ka të bëjë me barazinë gjinore janë ndarjet buxhetore për Agjencinë për Barazi Gjinore të cilat arrijnë në 354,173 €, krahasuar me 230,388 € në vitin 2022. Kjo rritje e buxhetit për ABGJ është parë në kategoritë buxhetore të mallrave dhe shërbimeve dhe pagave dhe Pagat për shkak të rritjes së numrit të stafit nga 19 në 2022 në 20 në 2023.

Një mjet shumë i rëndësishëm i BPGJ-së sipas kërkesave të Treguesit të OKB-së për SDG 5.c.1 janë qarkoret buxhetore. Qarkoret buxhetore të Kosovës ofrojnë një kornizë se si duhet të hartohet buxheti dhe si duhet të dorëzohet Aneksi i BPGJ-së, për të informuar ndarjet buxhetore për vitin e ardhshëm. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 37 nga 38 organizata buxhetore komunale (97%) dhe 45 nga 51 (88%) organizata buxhetore të nivelit qendror kanë dorëzuar aneksin e buxhetit të përgjegjshëm gjinor si pjesë e kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2023. , siç kërkohet nga qarkoret buxhetore të nxjerra nga Ministria. Ky është një përmirësim në krahasim me 70% për vitin 2022. Pa analizat e duhura gjinore brenda këtyre anekseve, komunat dhe ministritë nuk mund të identifikojnë me saktësi nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave të ndryshëm për të siguruar që kërkesat buxhetore do të adresojnë nevojat e tyre.

2 Artikulli 3, par. 1B.

3“Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe sigurimi i barazisë gjinore përmes fuqizimit të grave si dhe promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve”.

4 “Parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore”.

5“Rritja e mirëqenies sociale nëpërmjet ristrukturimit, zgjerimi në rritjen e cilësisë së mbrojtjes dhe shërbimeve sociale e familjare, me fokus të veçantë grupet në nevojë dhe barazinë gjinore”.

6 Treguesit e performancës janë futur për herë të parë në Ligjin për ndarjet buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës 2022

Megjithatë, këto anekse nuk janë përmendur fare në ligjin e buxhetit. As nuk është e qartë nëse informacioni në buxhet është nxjerrë nga këto të dhëna. Për më tepër, këto anekse nuk janë publikuar askund, sipas kërkesave të SDG 5.C.1., kështu që ato nuk mund të rishikoheshin apo analizoheshin nga publiku.

### Luftimi i dhunës me bazë gjinore

RrGK ka avokuar vazhdimisht që të ndahen më shumë para për strehimoret si dhe për të mbijetuarat e [dhunës seksuale. Strehimoret janë ofrues me përvojë të shërbimeve kryesore të kërkuara nga Konventa e Stambollit, të cilat institucionet nuk mund t'i ofrojnë. Në vitin 2021, pas avokimit të RrGK, 1,000,000€ ishin ndarë për linjën buxhetore “Shpenzimet themelore për strehimore” krahasuar me 880,000€ në vitin 2020. Qeveria ndau të njëjtën shumë për vitin 2022. Për vitin 2023, kjo shumë u rrit në 1,50€. Ndërsa kjo paraqet një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet e mëparshme dhe mbulon kostot bazë të funksionimit të strehimoreve, mund të mos jetë e mjaftueshme për shërbime gjithëpërfshirëse rehabilitimi dhe riintegrimi të parashikuara nga Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje \(Konventa e Stambollit\). Ky financim duhet të jetë konsistent, si linjë e përhershme buxhetore. Qeveria nuk i pranoi \[rekomandimet\]\(#\) e RrGK-së për rritjen e buxhetit për Qendrat për Punë Sociale si aktorë kyç në rastet mbështetëse, të cilat janë jashtëzakonisht të pamjaftueshme për të kryer \[detyrat\]\(#\) e tyre. Kosova ende ka nevojë të krijojë shërbime për adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore në përputhje me Konventën e Stambollit, veçanërisht shërbime për të mbijetuarat e dhunës seksuale, duke përfshirë punëtorë të mjaftueshëm social, trajnim adekuat për të gjitha institucionet që ndihmojnë rastet, qendrat e krizave të përdhunimeve, dhe qendrat e referimit të dhunës seksuale. Nuk është e qartë nëse është bërë ndonjë ndarje buxhetore për këto shërbime thelbësore ose për linjën emergjente telefonike të kërkuar nga Konventa e Stambollit. Për më tepër, deri në vitin 2025 është planifikuar të ndërtohet një strehimore për gratë viktime të dhunës në Ferizaj dhe shuma e ndarë për këtë është 80,000€. Megjithatë, kjo shumë është një projeksion për buxhetet e ardhshme për vitin 2024 dhe 2025, dhe jo për vitin 2023.](#)

### Ekonomia e Kujdesit

Gjetjet sugjerojnë se investimi në një rimëkëmbje ekonomike të qëndrueshme dhe të barabartë gjinore, duke përfshirë investimet në infrastrukturën sociale dhe mbrojtjen, mund të krijojë më shumë vende të reja pune dhe të përmirësojë mirëqenien për më shumë njerëz, duke përfshirë gratë dhe burrat.[7]

Investimi në ekonominë e kujdesit do t'u mundësojë më shumë grave të punojnë duke rritur disponueshmërinë e kujdesit, përmirësojnë rezultatet arsimore të fëmijëve, krijojnë vende pune, kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe rrisin të [ardhurat e shtetit](#). Kosova është zotuar të zgjerojë opsionet e kujdesit ndaj fëmijëve përmes [Strategjisë së saj Kombëtare për Zhvillim \(SKZH\) 2030](#), e cila identifikon ndër synimet e saj rritjen e numrit të kopshteve dhe institucioneve të kujdesit privat. Për më tepër, në kontekstin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), Kosova duhet të ndërmarrë hapa për të ulur papunësinë e grave, për të përmirësuar frekuentimin e arsimit parashkollor, për të ulur informalitetin dhe për të luftuar diskriminimin ndaj grave, të cilat të gjitha janë të ndërthurura me rritjen e disponueshmërisë së kujdesit ndaj fëmijëve[8]. Shuma e buxhetuar për Viti 2023 për arsimin parashkollor dhe kopshte është buxhetuar më së shumti në kategorinë e pagave dhe mëditjeve; një shumë e vogël është buxhetuar për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Buxheti është rritur vetëm pak në investime kapitale, si për vazhdimin e ndërtimit të çerdheve për fëmijë në Mitrovicë, Vushtrri, Klinë, Glllogoc, Prizren, Lipjan dhe Ferizaj.

RrGK ka rekomanduar gjithashtu për krijimin e një linje të qartë dhe të përhershme buxhetore, posaçërisht për financimin e Skemës së Asistencës Personale, e cila do t'u shpërndahet asistentëve personalë të cilët certifikohen si asistentë[9]. Aktualisht, ata punojnë për më pak se paga minimale dhe jashtë orarit të konsiderueshëm të papaguar, gjë që paraqet shkelje të të drejtave të punës. Gratë priren të preken në mënyrë disproporcionale, duke qenë se gratë priren të jenë kujdestare. Një rishikim i buxhetit sugjeron se nuk janë ndërmarrë hapa drejt ndarjes së burimeve të mjaftueshme për asistentët e personave.

7 RrGK, [Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë](#), 2016.

8 RrGK, [“Më shumë zgjedhje përmes politikave miqësore për familjen”](#), 2021.

9 RrGK, [Financimi i përgjegjshëm gjinor për shoqëruarit e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë](#), 2022.

## REKOMANDIME DHE VEPRIMET E PROPOZUARA

### RrGK rekomandon që Qeveria e Republikës së Kosovës:

- Të mbështet ABGJ-në dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për të finalizuar koncept dokumentin BPGJ dhe kornizën ligjore përkatëse për BPGJ-në në konsultim të ngushtë me organizatat drejtave të grave me përvojë në këtë fushë, si anëtarë të grupit punues. Institucionalizimi i BPGJ-së në sistemin e menaxhimit të financave publike duhet të jetë pjesë e reformave aktuale, në vazhdim të administratës publike dhe financave publike, drejt zbatimit të LBGJ, PEFA GRPFM, OKB SDG 5.c.1, dhe GAP III.
- Të sigurohet që ligjet e ardhshme për ndarjet buxhetore të jenë në përputhje me LBGJ-në, e cila parashikon integrimin gjinor të të gjitha politikave dhe programeve, si dhe aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Kjo përfshin sigurimin se vlerësimi i ndikimit gjinor është kryer në mënyrë të duhur për të informuar buxhetin dhe që përfshin analiza ndërsektoriale gjinore, duke u kujdesur për nevojat e grave dhe burimeve me aftësi të ndryshme, me moshë, etni dhe vendndodhje gjeografike të ndryshme, midis dallimeve të tjera sociale dhe demografike.
- Të publikojë së bashku me buxhetin një Deklaratë Buxhetore Gjinore dhe anekset e detyrueshme të BPGJ-së, duke i bërë ato të qasshme për publikun sipas udhëzimeve të PEFA GRPFM dhe OKB SDG 5.c.1. Të sigurohet që këto të kenë objektiva të qarta dhe tregues të performancës buxhetore në lidhje me barazinë gjinore për linja dhe sektorë të ndryshëm buxhetor, duke e lidhur buxhetin me zotimet e Kosovës mbi barazinë gjinore në programe dhe strategji të ndryshme. Kjo do të mundësojë monitorim dhe raportim më të qartë, më transparent se si buxheti po kontribuon në avancimin e barazisë gjinore.
- Të investoj në ekonominë e kujdesit, e cila mund të krijojë mijëra vende të reja pune në Kosovë. [10] Krijimi i opsioneve të reja për kujdesin ndaj fëmijëve krijon më shumë mundësi punësimi, lejon më shumë gra të bashkohen me forcën e punës për shkak të rritjes së disponueshmërisë, përmirëson rezultatet arsimore të fëmijëve dhe kontribuon në të ardhurat e shtetit. Kujdesi për të moshuarit, të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara gjithashtu duhet të merret parasysh pasi mund të krijojë vende pune dhe të transformojë punën e papaguar në punë me pagesë.
- Të krijoj një linjë të përhershme buxhetore për strehimoret për dhunën me bazë gjinore (përfshirë dhunën seksuale), si dhe ndarjen e burimeve të mjaftueshme për shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimin bazuar në llogaritjen e saktë të kostos dhe vlerësimin e kostove të viteve të mëparshme, duke përdorur praktikën më të mira në BPGJ. Të shpërndajë fondet në kohën e duhur në mënyrë që të gjitha strehimoret të kenë burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për të zbatuar Konventën e Stambollit. Të sigurohet që të ndahen burime adekuate për një Qendër të Krizës së Dhunimit, trajtim për të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe një linjë telefonike SOS, sipas Konventës së Stambollit.
- Të rrisë buxhetin e ndarë për Qendrat për Punë Sociale në kategorinë buxhetore Paga dhe Mëditje (rreth 456,000 € në vit) për të punësuar të paktën dy punonjës socialë në secilën komunë, të cilët do të fokusoheshin vetëm në trajtimin e rasteve të [dhunës me bazë gjinore](#).
- Të vendoset një linjë buxheti e qartë dhe e përhershme, posaçërisht për financimin e Skemës së Asistencës Personale, e shpërndarë për asistentët personalë që certifikohen si asistentë. [11] Bazuar në një analizë gjinore, vlerësoni buxhetin aktual të nevojshëm duke marrë parasysh kohën aktuale që kërkohet nga asistentët personalë, në mënyrë që të mos kontribuohet në shkeljet e të drejtave të punës. Të rritet shumica e buxhetuar për asistent personal nga 150 € aktuale për asistentët personal të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe 125 € për personat e verbër që të përputhet të paktën me pagën minimale (aktualisht 170 €) dhe idealisht me pagën mesatare (484 €). Planifikoni për inflacionin mundshëm në të ardhmen.

Përgatitur nga Ernera Dushica dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grave të Kosovës si pjesë e Rrjetit të Mbikqyrësve të Buxheteve Gjinore.

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)  
+381 (0) 38 245 850  
Rr.Kadri Gjata (ish. Feriz Blakçori),  
kati 2, nr. 8 10000 Prishtina, Kosovë



[10]RrGK, [Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë](#), 2016.

[11]RrGK, [Financimi i përgjegjshëm gjinor për shoqëruarit e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë](#), 2022.